



# **Llogaritë Rajonale në Shqipëri 2012**

## ***Parathënie***

INSTAT publikon botimin “Llogaritë Rajonale në Shqipëri” në përmbushje të detyrimeve në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Sipas Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit nënshkruar në vitin 2006, Shqipëria, në vitin 2011, duhet të prodhojë PBB e saj për frymë, sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS 2) të Bashkimit Evropian. Nomenklatura e njësive territoriale për statistikën (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbledhen dhe përpunohen statistikën rajonale evropiane. Statistikat Rajonale janë themeli i Sistemit Statistikor Evropian, të cilat përdoren për një sërë qëllimesh. Klasifikimi sipas NUTS është prezantuar nga Bashkimi Evropian për një ndarje të standardizuar me qëllim:

- i) Mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave në nivel rajonal;
- ii) Analizat socio-ekonomike të rajoneve;
- iii) Për alokimin e fondeve strukturore për zhvillim.

Prodhimi i statistikave rajonale ekonomike ka rëndësi të madhe në marrjen e vendimeve të rëndësishme në nivel kombëtar por edhe në politikën rajonale të BE-së për alokimin e fondeve strukturore. Zhvillimi rajonal është i lidhur me nxitjen e investimeve si rrjedhim i proceseve vendim marrëse me mbështetje nga statistikën rajonale të disponueshme.

Informacioni statistikor në këtë publikim shoqërohet nga koncepte dhe definicione bazë të aplikuara në Llogaritë Kombëtare dhe Rajonale si dhe me harta e grafikë të cilat reflektojnë rajonalizimin e treguesve makroekonomikë.

Informacioni i detajuar mbi nivelin e zhvillimit ekonomik sipas rajoneve dhe qarqeve do të jetë i dobishëm në analizat ekonomike duke ndjekur ndryshimet strukturore të rajoneve.

INSTAT ka rishikuar serinë kohore 2008-2012 të treguesve të Llogarive Kombëtare më 30 Maj 2014 dhe ka publikuar edhe një manual metodologjik rreth revizionimeve të fundit.<sup>1</sup> Këto ndryshime janë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji.

Publikimi përmban rezultate të llogaritjeve të Produktit të Brendshëm Bruto dhe përbërësve të tij për vitet 2008-2012 sipas 3 rajoneve statistikore niveli 2 dhe 12 rajoneve statistikore niveli 3 të harmonizuara me ndarjen e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Për të lehtësuar e ndihmuar lexuesit, të dhënat janë shprehur në Euro, Dollarë (USD) si dhe në treguesin e Standardit të Fuqisë Blerëse (PPS - Purchaser Power Standard) për efekte të krahasimeve ndërkombëtare.

---

<sup>1</sup> [http://www.instat.gov.al/media/244721/material\\_shpjegues\\_per\\_rishikimin\\_e\\_pbb-se\\_vjetore.pdf](http://www.instat.gov.al/media/244721/material_shpjegues_per_rishikimin_e_pbb-se_vjetore.pdf)

# Llogaritë Rajonale në Shqipëri

## *Përmbajtja*

<b>PARATHËNIE</b> .....	2
<b>PËRMBAJTJA</b> .....	3
1. <b>NDARJA E TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË RAJONE STATISTIKORE</b> .....	5
2. <b>LLOGARITË RAJONALE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2012</b> .....	6
2.1 PBB sipas Rajoneve Statistike nivelet 2 dhe 3.....	7
2.2 Rritja ekonomike e PBB-së sipas rajoneve statistikore.....	8
2.3 PBB për frymë sipas Rajoneve Statistike nivelet 2 dhe 3.....	9
2.4 PBB për frymë në PPS për Shqipërinë.....	10
2.5 Peshat ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore niveli 2 dhe 3, viti 2012.....	11
2.6 Vlera e Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe sipas Qarqeve.....	12
2.7 Pozicioni i Tiranës në Republikën e Shqipërisë.....	18
2.8 Diversiteti i rajoneve statistikore në Shqipëri.....	19
<b>ANEKSET</b> .....	20
Aneks A.1: Ndarja e Rajoneve statistikore NUTS 2 viti 2011.....	20
Aneks A.2: PBB korrente sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2012.....	21
Aneks A.3: PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2012.....	22
Aneks B: Tabelat.....	23

## Lista e Tabelave sipas Rajoneve Statistikore

Tabela B.1. Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve Statistikore Nivel 1, 2, 3 për vitet 2008-2012.....	23
Tabela B.2. Produkti i Brendshëm Bruto në çmime korrente.....	24
Tabela B.3. Produkti i Brendshëm Bruto me çmimet e vitit të mëparshëm.....	25
Tabela B.4. Produkti i Brendshëm Bruto në Euro.....	26
Tabela B.5. Produkti i Brendshëm Bruto në PPS.....	27
Tabela B.6. Rritja Reale e Produktit të Brendshëm Bruto.....	28
Tabela B.7. Popullsia mesatare në Shqipëri.....	29
Tabela B.8. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë në Lekë.....	30
Tabela B.9. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, në Euro.....	31
Tabela B.10. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, në PPS.....	32
Tabela B.11. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, AL=100.....	33
Tabela B.12. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, EU28=100.....	34
Tabela B.13. Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto e ndarë në degë të ekonomisë sipas e ndarjes Statistikore Rajonale 2 dhe 3 viti 2012*(Dega=100%).....	35
Tabela B.14. Ndarja e degëve ekonomike të VSHB-së për Rajonet Statistikore nivel 2 dhe 3, viti 2012* (Rajoni=100%).....	36
Tabela B.15. Rajoni Statistikor Durrësi dhe Veriu.....	37
Tabela B.16. Rajoni Statistikor Qendër.....	38
Tabela B.17. Rajoni Statistikor Jug.....	39
Tabela B.18. Qarku Dibër.....	40
Tabela B.19. Qarku Durrës.....	41
Tabela B.20. Qarku Kukës.....	42
Tabela B.21. Qarku Lezhë.....	43
Tabela B.22. Qarku Shkodër.....	44
Tabela B.23. Qarku Elbasan.....	45
Tabela B.24. Qarku Tiranë.....	46
Tabela B.25. Qarku Berat.....	47
Tabela B.26. Qarku Fier.....	48
Tabela B.27. Qarku Gjirokastrë.....	49
Tabela B.28. Qarku Korçë.....	50
Tabela B.29. Qarku Vlorë.....	51

## 1. Ndarja e Territorit të Republikës së Shqipërisë në Rajone Statistike

Në 28 Prill 2011 EUROSTAT konfirmoi propozimin e Institutit të Statistikave, të aprovuar nga Këshilli i Ministrave<sup>2</sup>, për ndarjen e Shqipërisë në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, përbërja e të cilave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

### Struktura rajonale e Shqipërisë sipas ndarjes NUTS

Rajoni Statistikor Niveli 1	Rajoni Statistikor Niveli 2	Rajoni Statistikor Niveli 3
Republika e Shqipërisë	Veri	Dibër
		Durrës
		Kukës
		Lezhë
		Shkodër
	Qendër	Elbasan
		Tiranë
	Jug	Berat
		Fier
		Gjirokastrë
		Korçë
		Vlorë

Ndarja e territorit të Republikës së Shqipërisë është në koherencë me rregulloren e Komisionit Evropian (KE-së) nr 1059/2003 mbi Parlamentin Evropian si dhe me Këshillin e tij më datë 26 maj 2003 mbi vendosjen e klasifikimit të njësive territoriale për statistikat (NUTS).

Numri i popullsisë për çdo njësi jo-administrative në nivel NUTS 2 është i harmonizuar me intervalin e vendosur nga Komisioni Evropian nga 800 mijë banorë në një maksimum prej 3 milionë banorësh.

Rajonet statistikore Niveli 3 janë njësi administrative (Qarqet). Numri mesatar i popullsisë për nivelin 3 është 241.707 banorë për vitin 2012 brenda intervalit 150 në 800 mijë banorë.

NUTS	Numri minimal i banorëve	Numri maksimal i banorëve
NUTS 1	3.000.000	7.000.000
NUTS 2	800.000	3.000.000
NUTS 3	150.000	800.000

<sup>2</sup> Vendimi i KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitet Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

## **2. Llogaritë Rajonale në Shqipëri për vitin 2012**

Vlerësimi i Llogarive Rajonale në Shqipëri bazohet në konceptet e Llogarive Kombëtare Vjetore. Ky është publikimi i katërt i Statistikave Rajonale në Shqipëri dhe është përpiluar duke ndjekur direktivat e metodologjisë ESA (Standardeve Evropiane të Llogarive), kapitulli XIII- Llogaritë Rajonale. Indikatorët rajonalë përfshijnë të dhëna për periudhën 2008-2012 të publikuara këto sipas rajoneve statistikore niveli 2 dhe 3 dhe sipas degëve kryesore të ekonomisë.

Publikimi përfshin indikatorët e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB), Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) të shprehura këto me çmime korrente dhe konstante për vitet 2008-2012. Treguesit makroekonomikë rajonalë janë të disponueshëm në 3 rajone statistikore nivel 2 si dhe në 12 rajone statistikore nivel 3 (e barazvlefshme me ndarjen administrative Qark). Vlerësimet janë në linjë me kërkesat e EUROSTAT.

### **2.1 PBB sipas Rajoneve Statistikore nivelet 2 dhe 3**

Në vitin 2012, sipas rajoneve statistikore niveli 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente ishte 1.335,5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 1,6 % krahasuar me vitin 2011.

Në vitin 2012 sipas rajoneve statistikore niveli 2, në rajonin Qendër, PBB me çmime korrente ishte 615,3 miliardë lekë ose 46,1 % ndaj totalit të PBB-së së vendit. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 1,6 %.

PBB me çmime korrente në Rajonin Jug ishte 399,7 miliardë lekë ose 29,9 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente u rrit me prej 1,0 %. PBB me çmime korrente në Rajonin Veri ishte 320,5 miliardë lekë ose 24,0 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 2,3 %.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3 (Qarqet) vlera më e ulët në PBB paraqitet në qarkun e Kukësit me 27,9 miliardë lekë ose 2,1 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente shënoi një rënie prej 4,3 %.

Vlera më e lartë në PBB paraqitet në qarkun e Tiranës me rreth 510 miliardë lekë ose 38,2 % e totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 2,1 %.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa nga rezultatet më të rëndësishme të Llogarive Kombëtare Rajonale në Shqipëri.

Ne aneksin A.2 mund të gjeni edhe hartën e shpërndarjes së PBB-së sipas rajoneve statistikore NUTS 3.

## PBB me çmime korrente, PBB për frymë e trajtuar sipas rajoneve statistikore nivel 2 dhe 3 , viti 2012

në Mln Lekë

Rajone statistikore niveli 2 / 3		PBB me çmime korrente (milionë Lekë)	PBB me çmime korrente (milionë Euro)	PBB me çmime korrente (milionë USD)	Struktura ndaj PBB-së (%)	PBB për frymë (mijë Lekë)	PBB për frymë (Euro €)	PBB për frymë (USD)	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	1.335.489	9.608	12.346	100	460.436	3.312	4.257	100
AL01	Veri	320.499	2.306	2.963	24,0	371.667	2.674	3.436	80,7
AL011	Dibër	43.236	311	400	3,2	309.670	2.228	2.863	67,3
AL012	Durrës	132.212	951	1.222	9,9	481.007	3.460	4.447	104,5
AL013	Kukës	27.898	201	258	2,1	319.935	2.302	2.958	69,5
AL014	Lezhë	45.349	326	419	3,4	327.027	2.353	3.023	71,0
AL015	Shkodër	71.805	517	664	5,4	323.480	2.327	2.990	70,3
AL02	Qëndër	615.338	4.427	5.689	46,1	564.942	4.064	5.223	122,7
AL021	Elbasan	105.245	757	973	7,9	346.054	2.490	3.199	75,2
AL022	Tiranë	510.093	3.670	4.716	38,2	649.737	4.674	6.007	141,1
AL03	Jug	399.651	2.875	3.695	29,9	421.150	3.030	3.893	91,5
AL031	Berat	54.192	390	501	4,1	371.324	2.671	3.433	80,6
AL032	Fier	166.222	1.196	1.537	12,4	520.813	3.747	4.815	113,1
AL033	Gjirokastrë	29.093	209	269	2,2	392.225	2.822	3.626	85,2
AL034	Korçë	72.962	525	675	5,5	321.697	2.314	2.974	69,9
AL035	Vlorë	77.182	555	714	5,8	422.054	3.036	3.902	91,7

\*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

## 2.2 Rritja ekonomike e PBB-së sipas rajoneve statistikore

Produkti i Brendshëm Bruto në vitin 2012, shënoi një rritje ekonomike reale në krahasim me vitin 2011 me 1,6 %.

PBB reale për vitin 2012 pati variacione në nivelet e rritjes sipas rajoneve statistikore nivel 3. Niveli i rritjes në vite dhe qarqe të ndryshme, varet nga kontributi individual i secilit qark në totalin e PBB-së, nga struktura e degëve të ekonomisë, etj. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ritmet e rritjes sipas rajoneve statistikore nivel 3:

Qarku=100	Rritja reale e PBB- së			
	2009	2010	2011	2012
Republika e Shqipërisë	3,4	3,7	2,5	1,6
Dibër	4,0	7,4	-2,3	13,2
Durrës	2,9	11,3	1,3	1,2
Kukës	4,3	3,8	4,5	-4,3
Lezhë	3,0	-1,8	1,6	9,6
Shkodër	4,3	6,8	-1,7	-2,7
Elbasan	2,4	12,9	5,6	-0,8
Tiranë	3,9	0,5	1,5	2,1
Berat	3,1	6,8	4,9	-2,1
Fier	1,6	6,7	3,3	8,6
Gjirokastrë	3,3	4,6	14,3	-11,3
Korçë	3,4	1,5	1,9	1,2
Vlorë	3,2	-4,5	6,8	-5,5




### 2.3 PBB për frymë sipas Rajoneve Statistikore nivelet 2 dhe 3

Në vitin 2012 niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë) ishte rreth 460 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2011 PBB për frymë u rrit me 2,7 %.

Në rajonet statistikore niveli 2, në rajonin Qendër, PBB për frymë në vitin 2012 ishte rreth 565 mijë lekë ose 22,7 % mbi mesataren e vendit. Krahasuar me vitin 2011, PBB për frymë në rajonin Qendër shënoi një rritje prej 0,9 %. Në rajonin Veri PBB për frymë në vitin 2012, ishte rreth 372 mijë lekë ose 19,3 % nën mesataren e vendit. Krahasuar me vitin 2011, PBB për frymë në rajonin Veri shënoi një rritje prej 3,1 %. Në rajonin Jug PBB për frymë në vitin 2012 ishte rreth 421 mijë lekë ose 8,5 % nën mesataren e vendit. Krahasuar me vitin 2011, PBB për frymë në rajonin Jug shënoi një rritje prej 5,0 %.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore niveli 3 (Qarqe) në vitin 2012 ishte Tirana me rreth 650 mijë lekë ose 41,1 % mbi mesataren e vendit dhe pati një rritje prej 0,8 % krahasuar me 2011. Më pas renditet Qarku i Durrësit me rreth 481 mijë lekë ose 4,5 % mbi mesataren e vendit, i cili pati një rritje prej 0,7 % krahasuar me 2011. Më pas renditet qarku i Fierit me rreth 521 mijë lekë ose 13,1 % mbi mesataren , i cili pati një rritje prej 16,1 % krahasuar me 2011. PBB për frymë për qarqet e tjera ishte nën mesataren e vendit ku më e ulta ishte ajo e qarkut të Dibrës me rreth 310 mijë lekë ose 32,7 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon qarku i Kukësit, me rreth 320 mijë lekë ose 30,5% nën mesataren e vendit. PBB-ja për frymë në Qarkun Korçë, është rreth 322 mijë lekë, ose 30,1 % nën mesataren e vendit. Në aneksin A.3 ndodhet edhe harta e PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore niveli 3.



## 2.4 PBB për frymë në PPS<sup>3</sup> për Shqipërinë

Si krahasim me nivelin ekonomik të vendeve të BE-së përdoret koeficienti i Standardit të Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS), i llogaritur nga EUROSTAT sipas deflatorëve të vendeve përkatëse.

PPS është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatët (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE28=100).

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse në vitin 2012 është 21.790 PPS ose 29,5 % e mesatares së Bashkimit Evropian BE28 = 100 . Sipas rajoneve statistikore niveli 2 në Rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2012 ishte 36,1 %, ndërsa në rajonet Veri dhe Jug ishte përkatësisht 23,8 % dhe 26,9 %.

Rajonet Statistikore	PBB për frymë në PPS (BE=100) në 2012
Republika e Shqipërisë	29,5
Rajone Statistikore Nivel 2	
Durrës dhe Veriu	23,8
Tiranë dhe Elbasan	36,1
Jugu	26,9

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme:

[http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/purchasing\\_power\\_parities/data/database](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/purchasing_power_parities/data/database)

*PBB për frymë në BE për vitin 2011*

Në vitin 2011 PBB për frymë, i shprehur në termat e Standardeve të Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standards-PPS) në 272 rajone NUTS 2 të BE28 (28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian) variojnë nga 29% të mesatares së BE28, në rajonin “Severozapaden” të Bullgarisë dhe “Nord-Est” të Rumanisë, deri në 321% të mesatares në “Inner London” të Britanisë së Madhe. Për informacion të hollësishëm ndiqni adresën e mëposhtme:

[http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY\\_PUBLIC/1-27022014-AP/EN/1-27022014-AP-EN.PDF](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_PUBLIC/1-27022014-AP/EN/1-27022014-AP-EN.PDF)


<sup>3</sup> Standardi i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard)

## 2.5 Pesha ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore niveli 2 dhe 3, viti 2012

Në rajonin statistikor niveli 3 pesha më e ulët ndaj totalit të PBB-së në rang vendi u shënuar në qarkun e Kukësit me 2,1 % dhe në qarkun e Gjirokastrës me 2,2 %. Ndërsa peshën më të madhe të PBB-së e shënoi qarku Tiranës me 38,2 %.

Në vitin 2012 pesha ndaj PBB-së për Rajonin Qendër ishte 46,1 % e totalit të Shqipërisë. Pesha ndaj PBB-së për Rajonin Jug ishte 29,9 % e totalit të Shqipërisë. Pesha ndaj PBB-së për Rajonin Veri ishte 24,0 % e totalit të Shqipërisë.

**Pesha ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore niveli 2,3 viti 2012**



## 2.6 Vlera e Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe sipas Qarqeve

Në vitin 2012, **dega e bujqësisë dhe peshkimit**, përbënte 21,83 % të totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare. Dega e bujqësisë dhe peshkimit pati një rritje prej 0,87 % në krahasim me vitin 2011.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha që ka pasur aktiviteti i bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit varion nga 4,71 % në qarkun e Tiranës në 42,72 % në qarkun e Beratit. Pjesa më e madhe e rajoneve statistikore nivel 2 dhe 3 kishin peshën e treguesve të bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit mbi mesataren e vendit. Pesha e degës së bujqësisë në rajonet statistikore specifike është paraqitur në tabelën më poshtë:

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Bujqësisë në gjenerimin e VSHB-së			
	2009	2010	2011	2012
Republika e Shqipërisë	19,41	20,66	20,96	21,83
<b>Qarku=100</b>				
Dibër	36,98	38,41	38,85	42,20
Durrës	14,25	14,57	14,21	16,62
Kukës	28,90	31,48	40,17	36,92
Lezhë	28,18	32,51	29,86	33,71
Shkodër	30,05	30,75	29,86	33,94
Elbasan	28,14	30,17	32,44	34,12
Tiranë	4,12	4,58	4,70	4,71
Berat	40,40	40,56	42,46	42,72
Fier	39,75	40,52	35,22	34,91
Gjirokastrë	34,28	33,66	34,10	37,17
Korçë	35,83	36,01	38,70	38,71
Vlorë	24,40	24,73	27,67	27,46

**Dega e Industrisë**, përbënte 14,43 % të totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare. Dega e industrisë pati një rritje prej 0,17 % në krahasim me vitin 2011.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e industrisë varioi nga 4,68 % në qarkun e Gjirokastrës e deri në 33,22 % në qarkun e Fierit. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së industrisë mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Korçë, Fier, Durrës dhe Elbasan. Pesha e degës së Industrisë në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Rajonet Statistikore	Pesha e Industrisë në gjenerimin e VSHB-së			
	2009	2010	2011	2012
Republika e Shqipërisë	11,55	14,33	14,25	14,43
<b>Qarku=100</b>				
Dibër	21,79	22,88	20,77	20,32
Durrës	12,96	15,72	16,09	15,49
Kukës	14,45	13,92	6,57	7,93
Lezhë	8,50	11,44	12,07	11,72
Shkodër	16,14	15,55	12,26	12,19
Elbasan	14,79	16,66	17,31	14,17
Tiranë	8,67	11,85	10,92	10,31
Berat	9,57	11,25	12,08	10,97
Fier	17,39	22,18	28,58	33,22
Gjirokastrë	8,38	8,96	6,53	4,68
Korçë	11,64	12,70	12,20	10,75
Vlorë	9,09	12,62	11,27	11,91

**Dega e Ndërtimit**, përbënte 12,15 % të totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare. Dega e ndërtimit pati një rënie prej 2,26 % në krahasim me vitin 2011.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e ndërtimit varioi nga 4,69 % në qarkun Dibër në 17,81 % në qarkun Tiranë. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së ndërtimit mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Tiranë, Vlorë, dhe Kukës.

Pesha e degës së ndërtimit në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Rajonet Statistikore	Pesha e Ndërtimit në gjenerimin e VSHB-së			
	2009	2010	2011	2012
Republika e Shqipërisë	17,12	14,60	14,41	12,15
<b>Qarku = 100</b>				
Dibër	7,12	6,82	5,40	4,69
Durrës	13,60	11,17	10,51	7,88
Kukës	19,49	17,46	16,24	15,36
Lezhë	16,90	13,55	13,76	10,67
Shkodër	11,58	14,88	15,27	9,79
Elbasan	10,52	8,03	7,87	8,24
Tiranë	23,48	20,51	20,29	17,81
Berat	13,86	11,72	11,20	10,46
Fier	8,96	7,03	6,80	5,62
Gjirokastër	14,59	12,95	13,44	6,71
Korçë	9,00	7,82	7,66	10,11
Vlorë	21,21	16,58	18,35	12,71

**Dega e Tregtisë, hotelerisë, transportit dhe komunikacionit** përbënte 21,93 % ndaj totalit të ekonomisë në gjenerimin e vlerës së shtuar bruto kombëtare.

Dega e tregtisë, hotelerisë, transportit dhe komunikacionit pati një rritje prej 0,33 % në krahasim me vitin 2011.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 7,85 % në qarkun e Dibrës në 33,97 % në qarkun e Durrësit. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së tregtisë, hotelerisë, transportit dhe komunikacionit mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Durrës dhe Tiranë.

Pesha e degës së tregtisë, hotelerisë, transportit dhe komunikacionit në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Rajonet Statistikore	<b>Pesha e tregtisë, hotelerisë, transportit dhe telekomunikacionit në gjenerimin e VSHB-së</b>			
	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
Republika e Shqipërisë	23,10	21,63	21,60	21,93
<b>Qarku=100</b>				
Dibër	10,56	8,18	8,32	7,85
Durrës	33,39	30,73	33,50	33,97
Kukës	13,15	13,01	11,44	11,08
Lezhë	19,87	14,77	15,55	16,90
Shkodër	14,66	11,68	13,18	12,68
Elbasan	20,95	22,86	20,16	19,82
Tiranë	28,16	28,44	28,42	29,74
Berat	16,25	13,89	13,86	14,18
Fier	16,12	12,59	12,17	10,32
Gjirokastër	19,77	14,83	14,16	14,60
Korçë	16,03	13,91	13,09	12,12
Vlorë	19,11	15,14	15,86	18,46

**Dega e Aktiviteteve Financiare, pasuritë e patundshme, si dhe qiradhënia** përbënte 13,77 % të totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare. Dega e aktiviteteve financiare, pasuritë e patundshme, si dhe qiradhënia pati një rritje prej 0,52 % në krahasim me vitin 2011.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e aktiviteteve financiare, pasuritë e patundshme, si dhe qiradhënia varioi nga 6,62 % në qarkun e Beratit në 19,98 % në qarkun e Tiranës. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së aktiviteteve financiare, pasuritë e patundshme, si dhe qiradhënia mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Gjirokastrë dhe Tiranë.

Pesha e degës së aktiviteteve financiare, pasuritë e patundshme, si dhe qiradhënia në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Rajonet Statistikore	<b>Aktivitete Financiare, pasuritë e patundshme, si dhe qiradhënia në gjenerimin e VSHB-së</b>			
	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
Republika e Shqipërisë	13,73	13,17	13,25	13,77
<b>Qarku=100</b>				
Dibër	5,19	4,71	7,44	6,91
Durrës	15,21	13,80	12,75	13,37
Kukës	5,63	5,89	7,49	8,56
Lezhë	10,82	9,88	11,84	10,97
Shkodër	9,78	10,31	12,44	12,37
Elbasan	8,17	7,08	7,48	7,51
Tiranë	19,46	19,42	18,65	19,98
Berat	5,59	5,16	6,12	6,62
Fier	7,92	7,34	7,87	7,45
Gjirokastrë	9,25	8,22	12,59	13,88
Korçë	9,50	9,01	9,55	9,28
Vlorë	12,70	13,02	12,70	13,45



**Dega e Shërbimeve të tjera** duke përfshirë administratën publike dhe të mbrojtjes, sigurimin e detyrueshëm shoqëror, përbënte 15,89 % ndaj totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare.

Dega e shërbimeve të tjera pati një rritje prej 0,37 % në krahasim me vitin 2011. Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 8,48 % në qarkun e Fierit në 22,96 % në qarkun e Gjirokastrës. Shumica e rajoneve statistikore niveli 3 me peshën e degës së shërbimeve të tjera ishin mbi mesataren e vendit. Pesha e degës së shërbimeve të tjera në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Rajonet Statistikore	<b>Pesha e Shërbimeve të tjera në gjenerimin e VSHB-së</b>			
	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
Republika e Shqipërisë	15,08	15,62	15,52	15,89
<b>Qarku=100</b>				
Dibër	18,36	19,01	19,22	18,04
Durrës	10,58	14,02	12,95	12,66
Kukës	18,37	18,24	18,10	20,15
Lezhë	15,74	17,85	16,91	16,03
Shkodër	17,78	16,83	16,99	19,04
Elbasan	17,43	15,21	14,74	16,14
Tiranë	16,12	15,19	17,02	17,44
Berat	14,32	17,41	14,28	15,06
Fier	9,87	10,33	9,36	8,48
Gjirokastrë	13,73	21,37	19,18	22,96
Korçë	18,00	20,55	18,80	19,03
Vlorë	13,49	17,90	14,14	16,02

## 2.7 Pozicioni i Tiranës në Republikën e Shqipërisë

Qarku i Tiranës, ku përfshihet kryeqyteti i Shqipërisë, midis 12 njësive statistikore nivel 3 ka pozicion të rëndësishëm. Këtu janë shumica e institucioneve qeveritare si dhe zyrat qendrore të kompanive më të rëndësishme multirajonale.<sup>4</sup>

Në vitin 2012 nga të dhënat më të fundit të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 Tirana kishte një popullsi prej 27,07 % të totalit të popullsisë në nivel vendi si dhe përbënte rreth 38,2 % të PBB-së në nivel vendi. PBB për banorë në qarkun e Tiranës ishte 41,5 % mbi mesataren e vendit.

Disa nga faktorët kryesorë që e veçojnë qarkun e Tiranës nga qarqet e tjera janë:

- Përqëndrimi i vlerës së shtuar të sektorit të ndërtimit
- Sektorët e shërbimeve (bankat, sigurimet, si dhe telekomunikacioni), etj
- Niveli i pagave mesatare i punonjësve është më i lartë mesatarisht në krahasim me rajonet e tjera
- Fluksi hyrës i punonjësve që vijnë nga rajonet e tjera.<sup>5</sup>

## 2.8 Diversiteti i rajoneve statistikore në Shqipëri

Rajonet Statistikore në Shqipëri Veriu, Qendra dhe Jugu kanë karakteristika të ndryshme demografike, në strukturën e degëve si dhe në performancën e tyre ekonomike.

Veriu ka një sipërfaqe prej 37,9 % të territorit, në vend të dytë për nga madhësia, dhe ka një popullsi prej 29,73 % ndaj totalit të vendit.

Rajoni Qendër ka një sipërfaqe prej 16,9 % të territorit, me përqindjen më të madhe të popullsisë prej 37,55 %, ndërsa rajoni Jug ka sipërfaqen më të madhe prej 45,2 %, me një përqindjen të popullsisë prej 32,72 % ndaj totalit.

Këto variacione në popullsinë rajonale reflektohen në masën e VSHB-së së prodhuar. Ndryshueshmëria midis rajoneve në përmasa të tyre bëjnë të vështirë krahasimin e performancës rajonale ekonomike duke përdorur të dhëna absolute. Këto variacione maten duke përdorur indikatorin për frymë të popullsisë.

Rritja ekonomike mund të variojë nga rritja për frymë në rajone ku popullsia është rritur ose zvogëluar. Për një informacion më të detajuar konsultohuni me tabelën më poshtë:

---

<sup>4</sup> Kompani me aktivitet në më shumë se një rajon brënda Republikës së Shqipërisë

<sup>5</sup> Commuters - Njerëz që punojnë në një rajon dhe jetojnë në një rajon tjetër.


## Tregues Rajonalë viti 2012

Rajoni Statistikor		Sipërfaqja	Popullsia mesatare 2012 <sup>6</sup>	Dendësia e Popullsisë
		km <sup>2</sup>	nr	Banorë/km <sup>2</sup>
<b>Niveli 1</b>	Shqipëria	28.748	2.900.486	100,9
			AI=100%	
<b>Niveli 2</b>	Veri	37,90%	29,73%	79,1
	Qendër	16,90%	37,55%	224,5
	Jug	45,20%	32,72%	73,1
<b>Niveli 3</b>				
<b>Veri</b>	Dibër	9,00%	4,81%	54,0
	Durrës	2,70%	9,48%	358,8
	Kukës	8,30%	3,01%	36,7
	Lezhë	5,60%	4,78%	85,6
	Shkodër	12,40%	7,65%	62,3
<b>Qendër</b>	Elbasan	11,10%	10,49%	95,1
	Tiranë	5,70%	27,07%	475,2
<b>Jug</b>	Berat	6,30%	5,03%	81,2
	Fier	6,60%	11,00%	168,9
	Gjirokastrë	10,00%	2,56%	25,7
	Korçë	12,90%	7,82%	61,1
	Vlorë	9,40%	6,30%	67,6

<sup>6</sup>Popullsia mesatare është mesatarja e popullsisë midis dy viteve të njëpasnjëshëm në fillim të vitit : 1/1/2012 dhe 1/1/2013


# Anekset

## Aneks A.1: Ndarja e Rajoneve statistikore NUTS 2 viti 2011




## Aneks A.2: PBB korrente sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2012

### PBB PER FRYME SIPAS QARQEVE




Qark



Kufijtë e komuneve dhe bashkiave janë krijuar për qëllime statistike dhe mund të mos përputhen plotësisht me territoret e njohura lokale.

### Aneks A.3: PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2012



**Tabela B.1. Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve Statistike Nivel 1, 2, 3 për vitet 2008-2012**

*në Mln Lekë*

Kodi	Nivelet Statistike	2008	2009	2010	2011	2012*
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>936.917</b>	<b>989.796</b>	<b>1.077.485</b>	<b>1.131.121</b>	<b>1.157.377</b>
AL01	<i>Veri</i>	221.411	236.724	266.491	271.558	277.755
AL011	Dibër	27.442	29.581	33.710	33.197	37.470
AL012	Durrës	89.229	94.938	109.731	112.989	114.579
AL013	Kukës	20.237	21.737	23.989	25.376	24.177
AL014	Lezhë	31.756	33.631	34.665	35.912	39.301
AL015	Shkodër	52.747	56.837	64.396	64.084	62.228
AL02	<i>Qendër</i>	447.898	474.632	504.342	524.828	533.272
AL021	Elbasan	68.694	73.294	86.749	92.060	91.209
AL022	Tiranë	379.204	401.338	417.592	432.767	442.063
AL03	<i>Jug</i>	267.608	278.440	306.652	334.735	346.350
AL031	Berat	37.015	39.098	44.128	47.477	46.964
AL032	Fier	96.066	96.827	113.752	125.797	144.053
AL033	Gjirokastrë	20.942	22.102	24.242	28.240	25.213
AL034	Korçë	52.629	56.225	59.968	62.437	63.231
AL035	Vlorë	60.956	64.189	64.562	70.784	66.889

*\*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale*

**Tabela B.2. Produkti i Brendshëm Bruto në çmime korrente**

*në Mln Lekë*

Kodi	Nivelet Statistikore	2008	2009	2010	2011	2012*
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>1.080.676</b>	<b>1.143.937</b>	<b>1.239.645</b>	<b>1.300.624</b>	<b>1.335.489</b>
AL01	<i>Veri</i>	255.793	273.588	306.598	312.252	320.499
AL011	Dibër	31.739	34.187	38.784	38.171	43.236
AL012	Durrës	103.018	109.722	126.245	129.921	132.212
AL013	Kukës	23.394	25.122	27.600	29.179	27.898
AL014	Lezhë	36.640	38.868	39.882	41.294	45.349
AL015	Shkodër	61.002	65.688	74.088	73.687	71.805
AL02	<i>Qendër</i>	516.834	548.546	580.245	603.475	615.338
AL021	Elbasan	79.339	84.708	99.805	105.856	105.245
AL022	Tiranë	437.495	463.838	480.440	497.619	510.093
AL03	<i>Jug</i>	308.049	321.802	352.802	384.897	399.651
AL031	Berat	42.694	45.187	50.769	54.592	54.192
AL032	Fier	110.129	111.906	130.871	144.648	166.222
AL033	Gjirokastër	24.152	25.544	27.890	32.472	29.093
AL034	Korçë	60.795	64.981	68.993	71.794	72.962
AL035	Vlorë	70.279	74.185	74.278	81.391	77.182

\*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale



**Tabela B.3. Produkti i Brendshëm Bruto me çmimet e vitit të mëparshëm**

*në Mln Lekë*

Kodi	Nivelet Statistike	2009	2010	2011	2012*
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>1.116.925</b>	<b>1.186.342</b>	<b>1.271.198</b>	<b>1.321.742</b>
AL01	<i>Veri</i>	264.798	293.252	307.975	319.588
AL011	Dibër	33.012	36.722	37.882	43.211
AL012	Durrës	106.044	122.117	127.874	131.452
AL013	Kukës	24.389	26.077	28.854	27.933
AL014	Lezhë	37.736	38.169	40.536	45.262
AL015	Shkodër	63.618	70.167	72.827	71.731
AL02	<i>Qendër</i>	535.898	561.897	593.223	613.281
AL021	Elbasan	81.266	95.655	105.381	105.012
AL022	Tiranë	454.632	466.242	487.842	508.268
AL03	<i>Jug</i>	316.229	331.192	370.001	388.873
AL031	Berat	43.998	48.273	53.276	53.452
AL032	Fier	111.861	119.365	135.219	157.058
AL033	Gjirokastrë	24.951	26.723	31.874	28.812
AL034	Korçë	62.892	65.986	70.280	72.638
AL035	Vlorë	72.527	70.845	79.352	76.912

\*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

**Tabela B.4. Produkti i Brendshëm Bruto në Euro***në Mln Euro*

Kodi	Nivelet Statistikore	2008	2009	2010	2011	2012*
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>8.798,1</b>	<b>8.660,9</b>	<b>8.999,2</b>	<b>9.268,3</b>	<b>9.607,8</b>
AL01	<i>Veri</i>	2.082,5	2.071,4	2.225,8	2.225,1	2.305,8
AL011	Dibër	258,4	258,8	281,6	272,0	311,0
AL012	Durrës	838,7	830,7	916,5	925,8	951,2
AL013	Kukës	190,5	190,2	200,4	207,9	200,7
AL014	Lezhë	298,3	294,3	289,5	294,3	326,3
AL015	Shkodër	496,6	497,3	537,8	525,1	516,6
AL02	<i>Qendër</i>	4.207,7	4.153,1	4.212,3	4.300,4	4.426,9
AL021	Elbasan	645,9	641,3	724,5	754,3	757,2
AL022	Tiranë	3.561,8	3.511,8	3.487,8	3.546,1	3.669,7
AL03	<i>Jug</i>	2.507,9	2.436,4	2.561,2	2.742,8	2.875,2
AL031	Berat	347,6	342,1	368,6	389,0	389,9
AL032	Fier	896,6	847,3	950,1	1.030,8	1.195,8
AL033	Gjirokastrë	196,6	193,4	202,5	231,4	209,3
AL034	Korçë	495,0	492,0	500,9	511,6	524,9
AL035	Vlorë	572,2	561,7	539,2	580,0	555,3

\*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

**Tabela B.5. Produkti i Brendshëm Bruto në PPS**

Në PPS

Kodi	Nivelet Statistike	2008	2009	2010	2011	2012*
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>20.172</b>	<b>20.560</b>	<b>20.651</b>	<b>21.522</b>	<b>21.790</b>
AL01	<i>Veri</i>	4.775	4.917	5.108	5.167	5.229
AL011	Dibër	592	614	646	632	705
AL012	Durrës	1.923	1.972	2.103	2.150	2.157
AL013	Kukës	437	452	460	483	455
